



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në pajtim me Rregulloren (2001/19) për Degën Egzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetë-Qeverisjes, me qëllim të implementimit efikas dhe të drejtë të Ligjit për Pensionit e Personave me Aftësi të Kufizuar (2003/23) i miratuar nga Kuvendi i Kosovës e shpallur si Rregullorja 2003/40 e UNMIK-ut, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 15/2004
PËR
ZBATIMIN E LIGJIT TË PENSIONEVE PËR PERSONA ME AFTËSI TË
KUFIZUAR

Neni 1

Autoriteti përkatës

- 1.1** Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me anë të kësaj autorizon Departamentin e Administrates Pensionale, duke përfshirë të gjitha zyret regjionale dhe zyret tjera të këtij Departamenti, si autoritet përgjegjës për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar.

Neni 2

Datat e Aplikimit dhe përzgjedhjes

- 2.1** Autoriteti përkatës do të pranojë aplikacionet për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar nga data e fuçizimit të Pensioneve për personat me aftësi të kufizuar 1 Korrik 2004.

- 2.2** Të gjithë parashtruesit e kërkesës, të cilët aplikojnë nga 01 Korriku 2004 deri më 31 Dhjetor 2004, do të gëzojnë të drejtën në pensionin e aftësisë së kufizuar në mënyrë retroaktive nga 1 Janar 2004.

Neni 3

Afatet Kohore për Vendimarrje

- 3.1** Në pajtim me Nenin 7.1 të Ligjit mbi Pensionet për personat me aftësi të kufizuar, data 1 Korrik 2004 është marrë si datë kur parashtruesit e kërkesave mund të përfitojnë Pensionet e personave me aftësi të kufizuar. Të gjitha aplikacionet e pranuar në mes të 1 Korrik 2004 dhe 30 Qershor 2005 do të kenë një vendim meritot nga Autoriteti përkatës përbrenda një viti kalendarik nga data e dorëzimit të aplikacionit.
- 3.2** Për aplikacionet e pranuar pas 1 Korrik 2005 Autoriteti përkatës do të vendos brenda gjashtë (6) muajsh pas pranimit të aplikacionit nga Autoriteti përkatës. Procedurat e Aplikimit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar

Neni 4

- 4.1** Aplikuesi me rastin e aplikimit do të merr formularin e aplikimit (DP 002), Çertifikatën e Mjekëve (DP DC 001), Fletushkën Informative mbi Çertifikatat Mjekësore (DP IL 002), Fletushkës Informative për Aplikuesin (DP IL 001) dhe Listën e Bankave (DP BL 001) nga Autoriteti përkatës.
- 4.2** Parashtruesi i kërkesës pastaj do të mbush formularin e aplikimit (DP 002) dhe Çertifikatat e Mjekëve (DP DC 001), për t'i prezentuar tek komisioni mjekësor.
- 4.3** Parashtruesi i kërkesës pastaj paraqitet tek zyret e autoritetit përkatës me të dy formularët e kompletuar (DP 002 dhe DP DC 001) së bashku me Kartelën Civile të Regjistrimit të UNMIK-ut.
- 4.4** Autoriteti përkatës do të pranoj aplikacionet kompletuara në pajtim me Procedurat Administrative të bashkangjitura (DP AP 003). Autoriteti përkatës pastaj do të lëshoj një vërtetim aplikuesit për të gjitha aplikimet e dorëzuara (DP RB 001).
- 4.5** Autoriteti përkatës pas kompletimit të dokumentacionit do të shqyrtoj lëndën e parashtruesit të kërkesës dhe do të njoftoj aplikuesin për datën dhe vendin e kontrollimit mjekësor ose njoftimi i aplikuesit do të jetë për vendim negativ.

Neni 5

Procedurat për punën të Komisioneve të Mjekëve

- 5.1** Ministria me anë të kësaj themelon tetë Komisione të Mjekëve me qëllim të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për Ndhim Socialë (Ligji për skemën e ndihmës sociale nr. 2003/15), Skemën e Invalidëve të Luftës dhe të afërmit e tyre (Rregullorja e UNMIK-ut 2000/66) dhe për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar (Ligji për pensionet e personave me aftësi të kufizuar nr. 2003/23).
- 5.2** Komisionet e Mjekëve në vitin e parë në veçanti do të koncentrohen dhe punojnë vetëm në Pensionet e personave me aftësi të kufizuar dhe atë gjer më 30 Qershor 2005.
- 5.3** Kryesuesi i Komisionit të Mjekëve (zyrtar nga MPMS-ja) është përgjegjës për listën e anëtarëve të Komisionit, duke organizuar kontrollime specialistike nëse është nevoja dhe duke mbajtur seanca të komisionit, në një mënyrë efektive dhe me kohë në mënyrë që të procesohen aplikacionet me kohë dhe t'i lejoj autoritetit përkatës kohë të mjaftueshme për të bërë vendime në pajtim me Nenin 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.
- 5.4** Kryesuesi i Komisionit të Mjekëve (zyrtar nga MPMS-ja) do të ketë një vijë menagjuese përgjegjëse të Menagjerit Regjional të Departamentit të Administratës Pensionale, gjersa do të ketë përgjegjësi funksionale menagjuese të Shefi Zyrtar Mjekësor (zyrtar nga MPMS-ja). Departamenti i Administratës Pensionale do të sigurojë gjithë përkrahjen e nevojshme administrative për Komisionin e Mjekëve.
- 5.5** Komisioni i Mjekëve dhe Autoriteti përkatës do të jenë përgjegjës për administrimin e kontrollave mjekësore në pajtim me Ligjin e Pensioneve të personave me aftësi të kufizuar, në veçanti me nenin 4, dhe Procedurat Administrative Mjekësore (DP MAP 001).
- 5.6** Të gjithë anëtarëve të Komisionit të Mjekëve u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë për metodat e punës në mënyrë që të sigurohet ngarkimi efektiv i detyrave të punës. Të gjitha këto deklaratë të tilla duhet mbajtur nga Autoriteti përkatës.
- 5.7** Procedurat për konsultime nga Komisioni i Mjekëve me specialistët shtesë do të jenë në pajtim me Procedurat e Administrimit Mjekësor (DP MAP 001) dhe marrëveshjet relevante me Ministrinë e Shëndetësisë.

- 5.8** Autoriteti përkatës do të mbaj të dhënat për të gjithë mjekët e licencuar në Kosovë, në pajtim me marrëveshjet relevante me Ministrinë e Shëndetësisë, kryesisht për implementimin e masave kontrolluese duke lëshuar çertifikatat e mjekëve, dhe përveç kësaj për kontrollimin e anëtarëve të Komisionit Mjekësor dhe çdo specialisti shtesë i konsultuar nga Komisioni.
- 5.9** Autoriteti përkatës do të mbaj dhe administroj një sistem të rezultateve nga të dhënat e fituara dhe të regjistruara të vlerësimeve mjekësore nga Komisioni i Mjekëve për secilin aplikues. Të dhënat e fituara do të konsiderohen si dëshmi për përcaktimin e shkallës së paaftësisë për Pensionin e personave me aftësi të kufizuar. Në sistemin e rezultatit mund të kenë qasje vetëm zyrtarët specifik të Autoritetit përkatës të autorizuar nga Drejtori i Departamentit të Pensioneve dhe Sektori i përkohshëm i MPMS. Sistemi i rezultatit do të konsiderohet si informatë konfidente dhe lëshimi i paautorizuar i informatave të rezultatit apo qasja në sistem nuk është e lejuar.

Neni 6

Procedurat e Pagesës

- 6.1** Në pajtim me paragrafin 6.3 të Ligjit të pensioneve për personat me aftësi të kufizuar të gjithë Pensionistët e zgjedhur me aftësi të kufizuar do të pranojnë pagesat përmes llogarisë së tyre personale.
- 6.2** Në pajtim me paragrafin 6.4 (a) të Ligjit mbi Pensionet për persona me aftësi të kufizuar, të gjithë personat që janë të paguar më tepër se shuma e përcaktuar me ligj-akt do të kenë zbritje në pagesën pasuese në shumën e njëjtë. Autoriteti përkatës do të informoj me shkrim pensionistët për gabimin dhe do të zbrit pagesat e ardhshme për të siguruar që gabimi është përmirësuar në kohën sa më të shkurtë të mundshme.
- 6.3** Në pajtim me paragrafin 6.2 të këtij Udhëzimi Administrativ, të gjithë pensionistët që kanë pranuar pagesë më tepër se shuma e përcaktuar dhe nuk janë më të zgjedhur për një Pension për personat me aftësi të kufizuar do të kthejnë shumën e tillë tek autoriteti përkatës. Autoriteti përkatës do t'i kërkoj me shkrim pensionistit kthimin e shumës së paguar apo të pronës së tyre, në rastin e vdekjes së një pensionisti.
- 6.4** Në pajtim me nenin 9 të Ligjit mbi Pensionet për persona me aftësi të kufizuar, të gjitha shumat e paguara më tepër personave të zgjedhur do t'i kthehet autoritetit përkatës. Autoriteti përkatës do të kërkojë me shkrim nga Pensionisti për kthim të menjëhershëm të shumës së paguar apo pronës së tyre, në rast të vdekjes së pensionistit. Nëse kjo kërkesë është e pasuksesëshme Autoriteti përkatës mund të vendos për të paraqitur rastin tek gjykata kompetente.

- 6.5** Në pajtim me paragrafin 6.4 (b) të Ligjit mbi Pensionet për persona me aftësi të kufizuar, në rastet e pagesave më pak se sa shuma e caktuar, Autoriteti përkatës do të paguaj shumën e papaguar në kohë më të shkurtër dhe sa më parë që është e mundur
- 6.6** Në rastet kur Autoriteti përkatës është i informuar që personi ka vdekur dhe pagesat e më tutjeshme janë në pajtim me paragrafin 6.3 të këtij Udhëzimi, apo në rastet e këtilla të tjera ku pagesat e më tejshme janë në pajtim, autoriteti përkatës do të bëjë pagesat anëtarit të familjes. Në rastin e parë pagesat e këtilla do t'i bëhen bashkeshortit/es të pensionistit. Nëse nuk ekziston bashkëshorti/ja atëherë pagesat do t'i bëhen fëmijut apo fëmijëve (në pjesë të barabarta), dhe nëse nuk ekziston bashkëshorti/ja apo fëmijët atëherë pagesat do t'u bëhen prindërve të pensionistit të vdekur. Autoriteti përkatës do të vendos se kush do të pranoj pagesat bazuar sipas vërtetimit të dokumentuar.
- 6.7** Në rastet kur parashtruesi i kërkeses për pensionin e aftësisë se kufizuar, vdes para se të shqyrtohet kërkesa e tij nga komisioni mjeksor, të drejtën në shfrytëzimin pensionit të aftësisë së kufizuar, do ta realizojn anëtarët e familjes së tij, sipas renditjes në paragrafin 6.6 në menyrë retroaktive nga 01/01/2004 deri në ditën e vdekjes së parashtruesit të kërkesës.
- 6.8** Kur autoriteti përkatës ka bërë pagesat në llogaritë bankare të pensionistëve me aftësi të kufizuar, përgjegjësitë për zbatimin e rregulloreve dhe procedurave i takojnë bankës përkatëse. Banka është përgjegjëse për administrimin e procedurës së tyre të brendshme për mbylljen e llogarive, me vdekjen e Pensionistit me aftësi të kufizuar. Autoriteti përkatës do të rigjej çdo pagesë të bërë më tepër në pajtim me nenet 6.3 dhe 6.4 të Ligjit për pensionet e aftësisë së kufizuar. Banka është përgjegjëse për të informuar autoritetin përkatës për Pensionistët me aftësi të kufizuar që kanë vdekur apo kanë lëshuar Kosovën.

Neni 7

Rregullorja e Kontrollës

- 7.1** Autoriteti përkatës do të hartoj dhe implementoj një rregullore kontrolluese administrative efektive për Pensionet për personat me aftësi të kufizuar. Kjo rregullore do të përdor mekanizmat efektive kontrolluese, përfshirë krahasimin e të dhënave për identifikimin e pensionistëve jomeritor, në pajtim me paragrafet 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 të Ligjit mbi Pensionet për persona me aftësi të kufizuara.
- 7.2** Autoriteti përkatës do të themeloj dhe implementoj një rregullore për kontrollim mjekësor për vlerësimin e aftësisë së kufizuar të pensionistëve dhe për kontrollimin e punës së Komisionit Mjekësor dhe lëshimin e çertifikatave mjekësore. Kjo rregullore do të jetë përgjegjësi e Shefit Zyrtar Mjekësor (zyrtar

nga Ministria). Kjo rregullore do të përdor mekanizmat efektive kontrolluese, duke përfshirë përdorimin e sistemit kontrollues për të kontrolluar punën e mjekëve individual dhe anëtarëve të Komisionit të Mjekëve. Personi i autorizuar për mbikëqyrjen e zbatimit të Rregullores së kontrollit është Sektori i Përkohshëm i MPMS.

Neni 8

Procedura e Ankesave

- 8.1** Këshilli i Ankesave i Autoritetit përkatës parashihet të veproj dhe funksionoj sipas dispozitave të nenit 10 të Ligjit për pensionet e aftësisë së kufizuar, andaj Autoriteti përkatës do të emëroj anëtarët e Këshillit duke përfshirë edhe Shefin Zyrtar Mjekësor nga Ministria.
- 8.2** Këshilli i Ankesave do të takohet rregullisht për të shqyrtuar të gjitha ankesat e aplikuesve më së paku njëherë në muaj.
- 8.3** Kryesuesi i Këshillit të Ankesave do të siguroj raporte mujore për Sekretarin e Përhershëm të MPMS të Ministrisë për të gjitha ankesat e pranuar, vendimet e bëra dhe rastet e veçanta. Ky raport do të respektoj mirëbesimin e ankuesit në pajtim me paragrafin 12 të Ligjit mbi Pensionet për personat me aftësi të kufizuar.

Neni 9

Hyrja në fuqi

- 9.1** Ky udhëzim Administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale.

Prishtinë, Gusht 2004

**Ministri i MPMS-së
Ahmet Isufi**
